

**AKTI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“BONI KEYS AL”**

Në bazë të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar, ligjit nr.9723, datë 03.05.2007, “Për Regjistrimin e Biznesit”, të ndryshuar, ligjit nr.131/2015, datë 26.11.2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, unë i nënshkruari:

- **Armend Perolli**, i biri i Reshatit dhe Bardhyles, lindur më 31.08.1972 në Prizren, Kosovë, dhe banues në adresën: rr. “Saraçëve”, nr.82-a, Prizren Kosovë, shtetas kosovar, identifikuar me letërnjoftimin me nr.personal ID1653256, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

sot më datë 27.02.2023, ditë e Heine, në Tiranë, shpall themelimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, të emërtuar “**BONI KEYS AL**”, nëpërmjet këtij akti themelimi me përbajtje si më poshtë vijon:

**NENI 1  
THEMELIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria e emërtuar “**BONI KEYS AL**”, me përgjegjësi të kufizuar, themelohet nga ortaku i vetëm:

- **Armend Perolli**, i biri i Reshatit dhe Bardhyles, lindur më 31.08.1972 në Prizren, Kosovë, dhe banues në adresën: rr. “Saraçëve”, nr.82-a, Prizren Kosovë, shtetas kosovar, identifikuar me letërnjoftimin me nr.personal ID1653256, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**NENI 2  
EMËRTIMI TREGTAR**


Emërtimi tregtar i shoqërisë është **BONI KEYS AL**.

**NENI 3  
SELIA E SHOQËRISË**

- Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: Rruga Asim Vokshi, pallati nr 92/1, kati i parë, Tiranë.
- Shoqëria mund të themelojë degë dhe filiale në të gjithë territorin e vendit si dhe jashtë tij, me miratimin e organeve kompetente dhe në përputhje me legjislacionin e vendit ku do të hapen këto degë.

**NENI 4  
KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar.



## NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë, është si më poshtë:

*“Çdo aktivitet që lidhet drejtpërdrejt me çelësat, pajisje dubluese dhe pajisje elektronike të destinuara për realizimin e çelsave, pajisjet elektronike të lidhura me çelësat ose dubluesit, si edhe aksesore dhe pjesë këmbimi të produkteve të sipër përmendura. Çdo aktivitet lidhur drejtpërdrejt me sistemet e sigurisë në përgjithësi. Çdo aktivitet që i referohet drejtpërdrejt sistemeve të sigurisë në përgjithësi, të tilla si brave, dry, kasaforta, telekomande dhe mjete diagnostike mekanike dhe elektronike për sistemet e sigurisë, pajisje për celesa dhe bravë të tillë si mobilje, ekrane, unaza kyce dhe pajisje të përdorura nga specialistë të bravave dhe çelsave, si edhe për qëllime të diversifikimit në sektoret e vendeve fqinje. Në lidhje me fushat e ndërhyrjes së sipër përmendur, aktivitetë të kërkimit, zhvillimit, planifikimit, prodhimit dhe shpërndarjes, të produkteve edhe ndaj të tretëve, në tregun shqiptar dhe të huaj, ndihmë teknike, si edhe ofrim të të gjitha shërbimeve të lidhura; të gjitha gjithashtu në emër të paleve te treta.vKrijimi i çelësive duke filluar nga produktet gjysmë të gatshme dhe duke përdorur pajisje industriale; punimet dhe tregtia e metaleve të vogla dhe aksesoreve të ndryshëm”.*

## NENI 6 KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË


- Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga **1 kuotë (pjesë), me vlerë 100 (njëqind) lekë**. **Kapitali themeltar është 100 % kontribut i ortakut të vetëm.** Kontributi i nënshkruar i kapitalit nuk është paguar.
- Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë për rritjen e kapitalit në perputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
- Detyrimet e ortakut kundrejt shoqërisë përballohen deri në vlerën e papaguar të kapitalit të nënshkruar. Për detyrimet e tjera të shoqërisë ortaku nuk mban pergjegjësi.

## NENI 7 PRANIMI I ORTAKËVE TË RINJ

Asambleja e Përgjithshme vendos për pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri.

## NENI 8 ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

- Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga organet e saj, të cilat janë:
  - **Asambleja e Përgjithshme**, e cila në momentin e themelimit të shoqërisë dhe deri në pranimin e ortakëve të rinj përbëhet nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë.
  - **Administratori**.
- Në momentin e themelimit, Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, shtetasë:



- **Armend Perolli**, i biri i Reshatit dhe Bardhyles, lindur më 31.08.1972 në Prizren, Kosovë, dhe banues në adresën: rr. "Saraçëve", nr.82-a, Prizren Kosovë, shtetas kosovar, identifikuar me letërnjoftimin me nr.personal ID1653256, me 100 % të kuotës së vetme të kapitalit me vlerë 100 (njëqind) lekë;
- Me themelimin e shoqërisë, administrator i parë i saj emërohet shtetasi:
  - **Armend Perolli**, i biri i Reshatit dhe Bardhyles, lindur më 31.08.1972 në Prizren, Kosovë, dhe banues në adresën: rr. "Saraçëve", nr.82-a, Prizren Kosovë, shtetas kosovar, identifikuar me letërnjoftimin me nr.personal ID1653256.
- Administratori i shoqërisë emërohet për një afat 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë riemërimi.
- **Mënyra e organizimit, funksionimit dhe drejtimit të shoqërisë përcaktohen në statutin e saj.**

### **NENI 9**

#### **SEKRETI PROFESIONAL**

Ortakët e shoqërisë, administratori dhe punonjësit janë të detyruar që të ruajnë sekretin e dokumentacionit dhe të informacionit, të siguruar gjatë ushtrimit të profesionit, si dhe të evitojnë përhapjen e tyre, qoftë edhe pjesërisht.

### **NENI 10**

#### **MOSMARRËVESHJET MES ORTAKËVE**

- Çdo mosmarrëveshje që mund të lindet mes ortakëve të shoqërisë, ose mes tyre dhe shoqërisë, do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet tyre.
- Nëse nuk arrihet zgjidhja e mosmarrëveshjeve me mirëkuptim, gjykatë kompetente për zgjidhjen e konfliktit do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

### **NENI 11**

#### **SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË**

Në rast se shoqëria shpërndahet për çdo lloj arsy, Asambleja e Përgjithshme përcakton mënyrën e likuidimit, emëron një ose më tepër likuidatorë dhe përgatit të gjitha dokumentet e nevojshme për ç'regjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Biznesit. Dispozitat e ligjit mbi shoqëritë tregtare janë të zbatushme.

**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"BONI KEYS AL"**

**ARMEND PEROLLI**